

## STATUTI DHE AKT THEMELIMI

### I SHOQERISE TREGETARE “SHPK” shpk

#### KREU I

#### DISPOZITA TE PERGJITHSHME

##### NENI 1

Sot me date 13/12/2024 sipas kerkesave te ligjit nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite trgetare” dhe te ligjit nr.9723 date 03.05.2007”Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit,i perditesuar krijohet shoqeria tregtare “**Craft**” **Shpk**, e cila do te veproje ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, nenet e ketij statuti si dhe aktit bashkengjitur tij.

#### KREU II

#### EMRI, STATUTI, SELIA, KOHEZGJATJA

##### NENI 2

Formohet shoqeria tregtare e emertuar “ **Craft shpk** ” shpk me themelues;

-Z. Enis Tufina me numer identifikimi ID: L1CW2K065 datelindjes 29-08-1973, lindur ne Tirane ,dhe banus ne Gjermani.

-Gabrle 1-von-SeId 1-Str. 45

-8 20 31 Grünwald

-Z Ferat Kastrati me numer identifikimi ID:CF61VT1WX datelindjes 14-10-1984 lindur ne Gjakove banues ne Bavari adress Frühlingstrasse 57a

82110 Germering

##### NENI 3

Shoqeria do te kete statusin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe do te perballoje humbje deri ne kufirin e kontributit te themeluesit te saj ne kapitalin themeltar.

##### NENI 4

Selia e shoqerise tregtare private “Craft shpk ” shpk, do te jete ne adresen:



:Rruga Bajram Curri,Godina Agimi,Hyrja2,Ap18,Zk.8270,nr pas 3/4+2-18 vo l  
1,fq17,Tirane

Ajo mund te cele dhe seli te tjera te dyta, dege e filiale, perfaqesi dhe agjensi operative ne  
te gjithë territorin e R.SH. dhe me miratim te organeve kompetente edhe jashte vendit.

#### **NENI 5**

Shoqeria do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saj me nje afat te pacaktuar, mbi 10  
vjet

#### **NENI 6**

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtje “ **Craft** ” sh.p.k.

#### **KREU III**

#### **OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

#### **NENI 7**

#### **Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte si me poshte:**

Shoqeria ka si objekt kryerjen e te gjitha aktiviteteve qe nje kompani me pergjegjesi te  
kufizuar mund te kryeje ne perputhje me legjislacionin e Shqiperise, brenda dhe jashte  
territorit te Republikes se Shqiperise, perfshire por pa u kufizuar ne :

Ndertim dhe rikonstruksione objektesh te ndryshme (pallate, godina banimi dhe sherbimi,  
etj).

Investime ne fushen e ndertimit, punime dheu, sistemime, taracime, ndertime civile,  
ekonomike, tregtare, bujqesore, kulturore, sportive, te veprave te kultit, te objekteve  
sociale, hoteleve, fshatrave turistike, etj. Ndertime Civile , ndertime industriale,  
projektme objektesh shume kateshe, objekte te rendesise se ve<;ante, rruges, tunelesh,  
urash, vepra ujore, hekurudhore, kanalizime, diga, vepra arti, impiante hidrike, rregullimi  
e sistemimi i tyre, asfaltim e punime te te gjitha kategorive qe perfshihen ne sistemin e  
ndertimeve, ndertime objektesh per banim dhe shtesa e rikonstruksione ne godina  
ekzistuese, mirembajtje fasadash, punime restaurimi, punime karpenterie, metalike,  
punime te mirembajtjes, sinjalizimit dhe vije zirit ne rruge.

Hapje farbrikash , ndertime hecesh ,prodhim dhe shitje energjie, hapje spitalesh, hapje te  
depove farmaceutike etj.

Konsulenca Juridike , Ndermjetesim, Konsulenca ne Fushen Minerare, Energjetike,



Mjedisore, Konsulenca te llojeve te tjera etj.  
Shitje -blerje e pasurive te palujatshme  
Import-Eksport dhe shitje mallrash te ndryshme, lende te para, industriale, makineri  
pajisje, bar kafe, restorant, agroturizem, hoteleri, etj.

## **KAPITALI**

### **NENI 8**

**Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke,dhe zotërohet si me poshte:**

**Z. Enis Tufina zoteron 49% te kuotave me vlere nominale 49000 leke kouta**

**Z. Ferat Kastrati zoteron 51 % te kuotave me vlere nominale 51000 leke kouta**

**Kapitali eshte ne vlere 100,000 leke e ndare ne 2 kuote.**

Kuotat e kapitalit themeltar jane te nenshkrueshme dhe te shlyeshme krejtesisht. Çdo kuote i takon e drejta e nje vote.

### **NENI 9**

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve te asamblese se ortakut te vetem, por asnjehere nuk mund te pakesohet nen nivelin e kapitalit themeltar.

### **NENI 10**

Ortaket mund t'u shesin te treteve kuotat e tyre te kapitalit pjeserisht ose teresisht, por pasi tua kene ofruar per blerje ortakut brenda shoqerise me kushte jo me pak te favorshme nga ato qe j'u ofrohen te treteve. Oferta i komunikohet me shkrim ortakut te cilet kane te drejten e parablerjes, e drejte qe duhet ta ushtrojne brenda 30 diteve nga data e komunikimit.

### **NENI 11**

Kapitali shoqerise do te perbehet nga kapitali themeltar, mjetet e xhiros dhe te tjera te nevojshme te luejtshme e te paluejtshme per ushtrimin e aktivitetit te shoqerise.



## **NENI 12**

**Heqja dore nga shoqeria nuk e liron ortakun nga detyrimet e lindura me pare ndaj shoqerise. Gjithashtu ai gezon te gjitha te drejtat e lindura para largimit te tij.**

## **ORGANI ADMINISTRATIV**

### **NENI 13**

**-Shoqeria "Craft " SHPK, do te kete si Administrator per nje periudhe 5-vjecare Z. Valbona Alla me numer ID I05129092U lindiur dhe banues ne Tirane**

**-.Ortaku i shoqerise ka kopetence te caktojne si administrator edhe persona te tjere te cilet nuk kane cilesine e ortakut, me nje afat prej 5 (pese ) tjetesh.**

### **NENI 14**

**Administratori ka te drejte te perfaqesoje shoqerine ne mardhenie me te tretet per permbushjen e aktivitetit te saj ne perputhje me nenin 6 te ketij statuti.**

**Organi Administrativ eshte kompetent per :**  
**te miratuar planet dhe bilancet periodike mujore dhe tre mujore;**  
**propozuar strukturen e aparatit te shoqerise;**  
**marre ne pune persona te ndryshem dhe rregullimin e mardhenieve te punes me ta;**  
**propozon rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve te ndryshme (te vecanta ),**  
**ndarjen e fitimit, etj. ;**  
**perfaqesuar apo emeruar perfaqesues ne ceshtje gjyqesore qe mund te kete shoqeria;**  
**perfaqesuar shoqerine ne regjistrin e prones sipas nenit 20 te ketij statuti.**

## **KREU V**

### **KUSHTET EKONOMIKE**

### **NENI 15**

Two blue ink signatures are present at the bottom of the page. The signature on the left is more complex and stylized, while the one on the right is simpler and more linear.

Shoqeria eshte pronare, perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo vepron ne regjistrin e prones si cdo person tjeter juridik ne Shqiperi, mund te bleje, te shese, te jape ne perdorim, te ngarkoje me barre per detyrime ndaj te treteve ose per kredi bankare, etj.

#### **NENI 16**

Shoqeria ka llogarine e saj rrjedhese, si dhe librin e saj te llogarive ne baze te kerkesave te ligjit per kontabilitetin e dispozitave te tjera fiskale. Transferimi i mjeteve monetare dhe transakcionet financiare do te kryhen ne baze te kriterëve te caktuara nga Banka e Shqiperise.

#### **NENI 17**

Veprimet ekonomiko-financiare te shoqerise nisin vitin e pare ne momentin e rregjistrimit ne organet tatimore, ndersa vitete tjera ne Janar dhe mbyllen ne 31 Dhjetor te cdo vit

Ne cdo fund periudhe ushtrimore hartohet bilanci kontabel sipas ligjeve ne fuqi brenda dates 31 Mars te vitit pasardhes nxirret bilanci. Bilancet periodike ( mujore, tremujore e gjashtemujore) miratohen e nenshkruhen nga Administratori e me pas ratifikohen ne asamblene e radhes. Bilancet vjetore miratohen nga asambleja dhe nenshkruhen nga administratoret.

#### **NENI 18**

Fitimi neto i realizuar nga shoqeria i mbetet ne perdorim ortakut te vetem ne kapitalin themeltar te shoqerise,mbasi te jene likujduar te gjitha detyrimet e te jete hequr fondi i rezerves ligjore, sipas vendimeve te asamblese.

Two blue ink signatures are present at the bottom of the page. The signature on the left is more complex and stylized, while the one on the right is simpler and more linear.

**KREU VI**  
**MAREDHENIET E PUNES**  
**NENI 19**

Mardheniet e punes ne kete shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk parashikohen ne to zbatohen dispozitat e Kodit te Punes ne R.Sh. Mosmarveshjet e punonjesve me shoqerine do te zgjidhen ne gjykatën shqiptare. Punonjesit e emeruar nuk marrin pjese ne ndarjen e fitimit te realizuar nga shoqeria gjate aktivitetit te saj , nese ne kontrate nuk eshte parashikuar ndryshe. Per punen e kryer punonjesit marrin page sic eshte parashikuar ne kontrate.

**KREU VII**  
**NENI 20**

Veprimtaria e shoqerise pushon me vendim te asamblese per shkaqet:

- veprimtaria rezulton negative
- pamundesi veprimi
- shperndahet me vullnetin e ortakut te vetem
- riorganizohet ne nje forme tjeter

**NENI 21**

Ne kushtet e nenit 23 te ketij statuti asambleja cakton nje ose me shume likujdatore te cilet marrin ne dore drejtimin e shoqerise duke kryer gjithë veprimet e likuidimit te saj, duke likujduar ne radhe te pare detyrimet ndaj shtetit e me pas ndaj te treteve. Ne rastin e teprices se kapitalit te shoqerise me perfundimin e likuidimit, kjo i shperndahet ortakut, ndersa ne rastin e pamjaftueshmerise se kapitalit ortakut eshte i detyruar te derdhi kuotat e tyre deri ne nivelin e kuotave te kapitalit themeltar.

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**NENI 22**

Shoqeria konsiderohet e krijuar ne perputhje me nenet e ketij statuti dhe aktit bashkelidhur dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit ne Tirane.

**NENI 23**

Per sa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet plotesimeve qe do te beje asambleja si dhe ligjeve te vecanta ne te cilat eshte referuar hartimi i ketij statuti. Ndryshimet dhe plotesimet e ketij statuti behen ne te njejten menyre e procedure me te cilen nxiret vete statuti.

**NENI 24**

Ky statut u perpilua ne prani te ortakut duke shprehur vullnetin e tij te lire. Ai u perpilua ne kater kopje me fuqi te barabarte secila per t'u depozituar ne Qendren Kombetare te Biznesit Tirane, ne zyren e Tatim -Taksave dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise.




**ORTAKET**

**E**

**THEMELIMITTE SHOQERISE "CRAFT SHPK" shpk**

**ENIS TUFINA  
FERAT KASTRATI**

Enis Tufina  


Ferat Kasthati

